



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

**Prosecverbal i Dëgjimit i publik për sektorin e Kulturës dhe Bujqësisë**

Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani ishte ai i cili e hapi këtë dëgjim publik, duke iu uruar mirëseardhje të gjithë të pranishmëve dhe duke e thekësuar se po vazhdojnë me dëgjimet publike për buxhetin e viti 2023.

Duke thekësuar se janë në komunikim të vazhdueshëm me qytetarët.

Drejtori Osmani gjithmonë vë në dukje se buxheti i Komunës së Podujevës këtë vit do të jetë 27. 406.566, që është buxheti më i madh në historinë e Komunës së Podujevës dhe është 4 milion euro më i madh se vitin e kaluar.

Buxheti i viti 2023 përfshinë të gjitha kategoritë, dhe në të gjitha këto kategori ka rritje të buxhetit. Kategoritë të cilat përfshihen në buxhet janë: kategoria e pagave, kategoria mallrave, kategoria e shërbimeve, dhe kategoria e investimeve kapitale dhe ajo e subvencioneve.

Poashtu Drejtori Osmani theksoi se ky dëgjim publik sot i atribuohet sektorit të Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Një pjesë e investimeve në këtë sektor janë nga Ministria e Financave por ka investime edhe nga ana e Komunës së Podujevës, e cila i ka të planifikuara investimet kapitale, në fushën e ndërtimeve të terreneve sportive apo investimeve të tjera dhe subvencionimeve për klubet dhe organizatat e tjera kulturore.

Në bazë të buxhetit Komuna e Podujevës i ka të aprovuara 200 mijë euro subvencione për klube sportive dhe për grupe kulturore dhe ka pesë fishim të buxhetit në këtë kategori.

Që nga viti 2021 është e aprovuar rregulloja për subvencione e cila i ndanë në mënyrë të barabartë dhe pa anime të gjitha subvencionet.

Drejtori Osmani e theksoi prapë arsyen e këitj debati publik që bëhet në kuadër të sektorit të kulturës dhe duke treguar se janë të gatshëm të pranojnë kërkresat e të pranishmëve, për investime në sport dhe në kulturë.

Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit, Pajtim Balaj falenderoj të gjithë të pranishmit për pjesmarrje dhe duke treguar se është në dijeni se problem më i madh i klubeve sportive në

Podujevë janë financat. Këtë përfundim tregon Drejtori Balaj se e ka nxjerrur gjatë takimeve të vazhdueshme që i ka me klubet sportive.

Në raport me kërkesat e klubeve sportive është parë e arsyeshme nga ana e Komunës që të rritet pjesa e subvencioneve. Klubet sportive që nga viti i ardhëm do të jenë në gjendje të marrin mbështetje maksimalisht 2 ose 3 fishin e asaj që kan marrë këtë vit.

Pa dyshim kjo do të ndikojë në rritjen e cilësisë theksoi Drejtori Balaj, duke u shprehur i hapur për kërkesat dhe pyetjet e të pranishmëve.

Qytetar i Podujevës – “ne si sporte problemin më të madh e kemi infrastrukturën, por një problem shumë i madh janë edhe parcelat, pra dihet që nuk ka parcela, por duhet të bëhet një zgjidhje”.

Qytetar i Podujevës – “klubet e qytetit të Podujevës kanë nevoj me ja u kriju kushtet. Sepse pa kushte nuk mund të bëhet as punë e mirëfillët. Sipas mundësive rriteni sa më shumë këtë buxhet, sidomos për infrastrukturën e të gjitha sporteve.”

Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë – “rruga lidhëse që lidh fshatin Llaushë dhe fshatin Dobërdol ka nevojë për asfaltim. Poashtu edhe rruga që i lidhë dy shkollat e Llaushës ka nevojë për asfaltim.”

Drejtori Osmani përgjigjet se këto rrugë në fjalë janë të evidentume edhe në kornizën buxhetore, Brenda vitit 2023 dhe poashtu brenda projeksjoneve buxhetore për vitet 2024 dhe 2025. Dhe çdo fshat është i përfshirë në investime buxhetore.

Ndërsa sa i përket investime në infrastrukturën sportive, ne si komunë e kemi të rregulluar që të përfshihet infrakstruktura sportive si në klube si nëpër shkolla apo kudo tjetër që ka klube sportive dhe pjesë të cilat janë të shfrytëzueshme pa pagesë. Gjithashtu do të kemi edhe rritje të investimeve jo sa të subvencioneve por do të ketë rritje.

Drejtori i Kulturës Rinisë dhe Sportit, Pajtim Balaj përgjigjet se investime shumë të mëdha siç është stadium i Podujevës, Komuna e ka shumë të vështirë t'i bëjë vetë. Ne jemi gjithmonë në tentativë për të gjetur bashkëpunime të tilla. Sa i përket atletikës ne kemi bërë një kërkesë për të krijuar shtigjet e atletikës. Në diskutim me Ministrin, Sekretarin dhe Zëvendës Ministren e Sportit ne kemi marrë një përgjigje joformale, se kjo punë do të kryhet. Për investime të mëdha Komuna e Podujevës ka mungesë të madhe të pronave, sidomos në qytet dhe në disa fshatëra përreth.

Banor i Podujevës – “sallat e sportit sidomos ulëset nuk i kanë shumë të rregulluara mirë, por kam ndëgjuar se u aprovu projekt i ri, çfar ka ndodhur?”

Drejtori Balaj shpjegoi se në sallën aktuale janë bërë disa investime yitin e kaluar por është edhe projekt i ri, i cili është i nënshkruar në vitin 2017 ose 2018. Por ka disa ngecje edhe nga

qeverisja e kaluar, dhe Komuna e Podujevës është duke punuar në këtë drejtim, për zgjedhjen e këtyre problemeve. Projekti i palestrës së re është shumë i mirë, dhe ka mjaftueshëm numër të ulëseve.

Banor i Podujevës – “ju përgëzoj për punën dhe shpresojë që do të vazhdoni të punoni në këtë drejtim, pasi që të investosh në rini është shumë gjë e mirë.”

Drejtori Osmani i falenderon të gjithë pjesmarrësit dhe i inkurajon poashtu që kërkesat e tyre ti drejtojnë dhe me shkrim, cilatdo qofshin kërkesat. Sepse pesëfishimi i buxhetit tregon që ne e kemi prioritet për herë të parë zhvillimin e Kulturës dhe Sportit.

Banor i Podujevës – “në shkollën “Dëshmorët e Kombit” ka hapsirë të mjaftueshme dhe ka nevojë për një sallë në atë shkollë.”

Drejtori Fatlum Osmani përgjigjet se Komuna e merr me shumë përgjegjësi çdo kërkesë por kjo varet edhe nga buxheti që kemi si komunë. E sa i përket arsimit nëse e krahasojmë me vitin e kaluar ka 15 herë më shumë buxhet për investime në shkolla. Këto investime kanë arritur vlerën 1 milionë e 660 mijë.

Në Komunën e Podujevës arsimi, Kultura, Sporti dhe zhvillimi Ekonomik janë prioritet.

Ndërsa drejtori Balaj shtoi se do ta kenë prioritet investimin në lagjet e qytetit sepse në kuadër të Kulturës ka pasur investime shumë pak. E kemi aktive një kontratë për ndërtimin e një fitnesi të hapur mbrapa kafeve në park të qytetit, pjesë e cila nuk frekuentohej shumë. Poashtu një fushë të basketbollit mbrapa postës së qytetit. Që do të thotë idea është që të ndërtojmë infrastrukturë në çdo lagje të qytetit.

Edhe pse prap këtu problem është prona por që ne besojmë se në bashkëpunim me komunitetin do të arrijmë të krijojmë këto kushte për të rinjët.

Me kaq përfundon edhe dëgjimi publik për sektorin e Kulturës dhe Bujqësisë.

## **18 gusht, Podujevë**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjim Publik për Buxhetin e vitit 2023 – Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrëseve  
(Debati për Kulturë, Ekonomi dhe Bujqësi)

|    | Emri dhe mbiemri | Vendbanimi | Nr.telefonit | Nënshkrimi |
|----|------------------|------------|--------------|------------|
| 1  | Rexhep OMER      | Llaçhto    |              |            |
| 2  | EPTMIN JENI STA  | Podujeve   |              |            |
| 3  | Gjumbarith Shala | Pochigjësi |              |            |
| 4  |                  |            |              |            |
| 5  |                  |            |              |            |
| 6  |                  |            |              |            |
| 7  |                  |            |              |            |
| 8  |                  |            |              |            |
| 9  |                  |            |              |            |
| 10 |                  |            |              |            |
| 11 |                  |            |              |            |
| 12 |                  |            |              |            |
| 13 |                  |            |              |            |
| 14 |                  |            |              |            |
| 15 |                  |            |              |            |
| 16 |                  |            |              |            |
| 17 |                  |            |              |            |
| 18 |                  |            |              |            |
| 19 |                  |            |              |            |
| 20 |                  |            |              |            |
| 21 |                  |            |              |            |
| 22 |                  |            |              |            |
| 23 |                  |            |              |            |
| 24 |                  |            |              |            |

|    |  |  |  |
|----|--|--|--|
| 25 |  |  |  |
| 26 |  |  |  |
| 27 |  |  |  |
| 28 |  |  |  |
| 29 |  |  |  |
| 30 |  |  |  |
| 31 |  |  |  |
| 32 |  |  |  |
| 33 |  |  |  |
| 34 |  |  |  |
| 35 |  |  |  |

**Podujevë**

**18.08.2022**



**Komuna e Podujeves - Detajme Publike për Buxhetin 2022-2023**

TMI I RADI